

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7889
E hënë, 23 shtator 2024
Çmimi 0.50

26 vjet nga rënia
e heronjve Fehmi dhe
Xhevë Lladrovci dhe
dëshmorëve të tjerë | **FAQE 6**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ALARMI TAKTIK I KURTIT

| **FAQE 4-5**



Brenda një jave kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka tërhequr vërejtjen së paku dy herë për rrezikun e konflikteve të reja nga

Serbia. Pavarësisht prej bisedimeve me vite, Kosova dhe Serbia duket se nuk po mund të gjejnë gjuhë të përbashkët. Atë jo

vetëm e kanë të vështirë të komunikojnë, por e akuzojnë vazhdimisht njëra-tjetrën se nuk duan paqe

**RRETH 1 500 RASTE
TË REJA ME KANCER,
NUMRI I TË RINJVE TË
PREKUR NË RITJE** | **F. 3**



**BASHKËPUNIMI
RAJONAL,
PARALAJMËRIMI
GJERMAN PËR
KOSOVËN KËRROHET
TË MERRET
SERIOZISHT** | **F. 3**




AKTUALE



**OKB-ja MIRATON PAKTIN PËR "NJË
TË ARDHME MË TË NDRITUR" PËR
NJERËZIMIN** | **F. 2**

**GËRVALLA NË NJU-JORK MERR
PJESË NË JAVËN E NIVELIT TË LARTË
TË SESIONIT TË 79 TË KOMBEVE TË
BASHKUARA** | **F. 3**

**MINISTRI I MBROJTJES:
FSK-ja DO TË KETË HELIKOPTERË
NGA 2025-ta** | **F. 3**



EKONOMI



**ZERO TAKSA PËR REGJISTRIMIN E
VETURAVE ELEKTRIKE. A MJAFTON?** | **F. 8**

SPORT



**KASTRIOTI LUFTON DERI NË FUND,
POR MEGJITHATË ELIMINOHET** | **F. 10**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB-ja miraton paktin për 'një të ardhme më të ndritur' për njerëzimin

NJU-JORK, 22 SHTATOR - Kombet e Bashkuara miratuan më 22 shtator një "Pakt për të ardhmen" që synon adresimin e sfidave të shumta të shekullit, nga konfliktet te ndryshimet klimatike dhe të drejtat e njeriut, pavarësisht prej kundërshtimeve të minutës së fundit nga një grup vendesh të udhëhequra nga Rusia.

Sekretari i përgjithshëm, Antonio Guterres, i cili organizoi "Samitin për të ardhmen", e cilësoi atë si një "mundësi që vjen një herë në një gjeneratë" për ta rishikuar historinë njerëzore duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar. Si një akt hapës për javën e nivelit të lartë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, që fillon më 24 shtator, dhjetëra kryetarë shtetesh dhe qeverish u mbledhën për nënshkrimin e tekstit.

Në versionin e miratuar udhëheqësit u zotuan ta forcojnë sistemin multilateral për ta "mbajtur ritmin me një botë që po ndryshon" dhe për t'i "mbrojtur nevojat dhe interesat e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm" përballë "krizave të vazhdueshme". "Ne besojmë se ka një rrugë drejt një të ardhmeje më të ndritur për gjithë njerëzimin", thuhet në dokument.

Pakti përmban 56 "veprime", përfshirë angazhimet për multilateralizëm, mbrojtjen e Kartës së OKB-së dhe ruajtjen e paqes. Ai bën thirrje për reforma në institucionet financiare ndërkombëtare dhe në Këshillin e

Sigurimit të OKB-së, së bashku me përpjekjet e ripërtëritura për t'i luftuar ndryshimet klimatike, për ta promovuar çarmatimin dhe për ta udhëhequr zhvillimin e inteligjencës artificiale.

Miratimi i tekstit u përball me një vonesë të shkurtër kur zëvendësministri i Jashtëm i Rusisë, Sergey Vershinin, paraqiti një amendament që theksonte "parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve". Kundërshtimet e Rusisë u mbështetën nga aleatët e saj, si Bjellorusia, Koreja e Veriut, Irani, Nikaragua dhe Siria, por amendamenti i saj u hodh poshtë me shumicë.

Gjatë fazës së negociatave, Guterres i kishte nxitur kombet të tregojnë "vizion" dhe "guxim", duke bërë thirrje për "ambicie maksimale" për t'i forcuar institucionet ndërkombëtare për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive kërcënimeve të sotme.

Megjithatë, përderisa ka disa "ide të mira", teksti "nuk është dokumenti revolucionar që reformon gjithë multilateralizmin, siç kishte kërkuar fillimisht Antonio Guterres", tha Richard Gowan nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave për AFP-në.

Ngjashëm u shprehën shumë diplomatë, të cilët shprehën zhgënjim kur diskutuan për ambicien dhe ndikimin e tekstit, duke e përshkruar atë si "të vakët", "emëruesi më i ulët i përbashkët", dhe "zhgënjyes".

"Idealisht do të dëshironim ide të



reja, ide të freskëta", tha një diplomat.

Lufta kundër ngrohjes globale ishte një nga pikat e debatit në negociatën, me referenca për "tranzicionin" larg karburanteve fosile që ishin zhdukur nga drafti i tekstit disa javë më parë përpara se të riktheheshin.

Pavarësisht prej kritikave, pakti është ende "një mundësi për ta pohuar angazhimin tonë kolektiv ndaj multilateralizmit, edhe në kontekstin e vështirë gjeopolitik aktual", tha një diplomat perëndimor, duke theksuar nevojën për ta rindërtuar besimin midis Veriut dhe Jugut Global.

Vendet në zhvillim kanë qenë veçanërisht të zëshme në kërkesën për angazhime konkrete për reformimin e institucioneve financiare ndërkombëtare, duke synuar të sigurojnë qasje më të lehtë në financime preferenciale, veçanërisht duke marrë parasysh ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Teksti përfshin me të vërtetë "angazhime të rëndësishme për drejtësi ekonomike dhe reformimin e arkitekturës financiare ndërkombëtare", komentoi Human Rights Watch (HRW), duke lavdëruar gjithashtu "fokusin në të drejtat e njeriut".

Megjithatë, udhëheqësit botërorë "ende duhet të tregojnë se janë të gatshëm të veprojnë për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut", tha Louis Charbonneau, drejtor i HRW për OKB-në.

Pavarësisht prej përmbajtjes së tij, pakti dhe anekset e tij - një Pakt Global Digital dhe një Deklaratë mbi Brezat e Ardhshëm - nuk janë ligjërisht obliguese, duke ngritur kështu shqetësime për zbatimin, veçanërisht pasi disa parime - si mbrojtja e civilëve në konflikte - shkelen çdo ditë. "Detyra jonë e ardhshme është t'u japim jetë atyre për t'i kthyer fjalët në veprime", tha Guterres.

BE-ja dhe Britania kërkojnë armëpushim në mes të Izraelit dhe Hezbollahut

BRUKSEL, 22 SHTATOR - Bashkimi Evropian dhe Britania e Madhe janë shprehur të shqetësuara nga përshkallëzimi i sulmeve në mes të Izraelit dhe grupit Hezbollah të Libanit - të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja.

Shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell, bëri thirrje për një armëpushim "të menjëhershëm", pasi tensionet në kufirin mes dy vendeve kanë shtuar frikën e një lufte më të gjerë në rajon. "Bashkimi Evropian është jashtëzakonisht i shqetësuar për përshkallëzimin në Liban pas sulmeve të së premtes në Beirut", tha Borrell në një deklaratë, duke bërë thirrje për një "armëpushim" përgjatë vijës kufitare që i ndan, "si dhe në Gaza".

Ndërkohë, edhe sekretari i Jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar, David Lammy, bëri thirrje për një "armëpushim të menjëhershëm" pas një "përshkallëzimi shqetësues" midis Izraelit dhe Hezbollahut. "Mesazhi ynë për të gjitha palët është i qartë: kemi nevojë për një armëpushim të



menjëhershëm nga të dyja palët, në mënyrë që të arrijmë një zgjidhje politike, që izraelitët dhe civilët libanezë të mund të kthehen në shtëpitë e tyre dhe të jetojnë në paqe dhe siguri", tha Lammy gjatë një fjalimi në

konferencën vjetore të partisë Laburiste.

Ndërsa zëdhënësi i Sigurisë Kombëtare të Shtëpisë së Bardhë, John Kirby, tha se një përshkallëzim rajonal ushtarak nuk është "në interesin më të

mirë" të Izraelit. "Ne nuk besojmë se përshkallëzimi i këtij konflikti ushtarak është në interesin e tyre më të mirë", tha Kirby për ABC, duke shtuar se Shtetet e Bashkuara "po ua thonë këtë drejtpërdrejt homologëve tanë izraelitë".

Izraeli dhe grupi libanez Hezbollah, i mbështetur nga Irani, kanë shkëmbyer sulme të përshkallëzuara në kufi, përfshirë një zjarr intensiv raketash gjatë natës në veriun e Izraelit, që detyroi qindra mijëra njerëz të fshiheshin në strehimore, sipas ushtrisë izraelite. "Tensionet janë shumë më të larta tani sesa ishin vetëm disa ditë më parë", tha Kirby.

Megjithatë, ai shtoi se "ne ende besojmë se ka hapësirë dhe kohë për një zgjidhje diplomatike dhe për këtë po punojmë".

Grupi Hezbollah i Libanit lëshoi mbi 100 raketa në orët e hershme të mëngjesit të 22 shtatorit drejt një zone më të gjerë dhe më të thellë brenda Izraelit verior. Breshëria e raketave gjatë natës

shkaktoi sirena alarmi në të gjithë veriun e Izraelit, duke i detyruar mijëra njerëz të futen në strehimore. Ushtria izraelite tha se raketat ishin lëshuar "drejt zonave civile", duke sinjalizuar një përshkallëzim të mundshëm, pasi më parë raketat ishin përqendruar kryesisht në objektiva ushtarake.

Ky sulm me raketa erdhi pas një sulmi ajror izraelit në Beirut më 20 shtator, që vrau të paktën 37 persona, përfshirë një nga udhëheqësit kryesorë të Hezbollahut, si dhe gra dhe fëmijë. Hezbollahu ishte ende duke u përballur me një sulm të sofistikuar që shkaktoi shpërthimin e mijëra pajisjeve personale vetëm disa ditë më parë. Ushtria izraelite tha se kishte kryer një valë sulmesh në jug të Libanit gjatë 24 orëve të fundit, duke goditur rreth 400 objektiva militantësh, përfshirë lëshues raketash. Zëdhënësi ushtarak izraelit, nënkolonel Nadav Shoshani, tha se këto sulme kishin parandaluar një sulm edhe më të madh.

Gërvalla në Nju-Jork merr pjesë në Javën e Nivelit të Lartë të Sesionit të 79 të Kombeve të Bashkuara

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka arritur në Nju-Jork. Në kuadër të Javës së Nivelit të Lartë të sesionit të 79 të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të

Bashkuara, ajo do të zhvillojë takime me përfaqësues të lartë të shteteve dhe organizatave të ndryshme botërore. Ministrja Gërvalla do të jetë edhe pjesë e takimeve të ndryshme shumëpalëshe të cilat do të trajtojnë tema të sigurisë globale dhe rajonale,

politikës dhe ekonomisë. Së bashku me kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ministrja Gërvalla do të mbajë takime të ndryshme me komunitetin shqiptar në ShBA, përfaqësues të ndryshëm të shoqatave dhe mekanizmave të ndryshëm shoqërorë.



Ministri i Mbrojtjes: FSK-ja do të ketë helikopterë nga 2025-ta



PRISHTINË, 22 SHTATOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë në një intervistë për Ekonomia Online se procesi i transformimit të Forcës Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri është në fazën e dytë. Por, sipas tij, me rritjen e buxhetit për FSK-në shumë pajisje ushtarake që janë paraparë të procedohen në fazat e mëvonshme janë blerë. Maqedonci ka thënë se në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit është paraparë që FSK-ja ta ketë edhe flotën e helikopterëve e cila parashihet të bëhet në fazën e tretë, që nënkupton nga viti 2025

deri në vitin 2028. Ministri ka thënë se Ministria e Mbrojtjes është duke e mbështetur FSK-në për arritjen e objektivave të fazës së dytë të tranzicionit, fazë kjo që pritet të kulmojë me validimin e tre regjimenteve të këmbësorisë së FSK-së, të cilat do të jenë të gatshme për ta realizuar detyrën kyçe të tyre, që është mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit. "Në vitin e gjashtë jemi të planit të gjithëpërfshirës të tranzicionit, apo në fazën e dytë për shkak se plani gjithëpërfshirës i tranzicionit të

FSK-së, i hartuar edhe në bashkëpunim me ShBA-në, është i ndarë në tri faza. Faza e parë ka qenë prej vitit 2019 deri në vitin 2022. Fokus kryesor faza e parë ka pasur përpilimin e gjithë doktrinës së nevojshme, dokumentacionit të nevojshëm për funksionimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, miratimin e programeve trajnuese të FSK-së, si dhe përpilimin e kërkesave për sisteme të armatimit dhe për pajisje të tjera për nevojat e FSK-së. Aktualisht jemi në fazën e dytë të tranzicionit. MB po e mbështet me të gjitha aspektet FSK-në për

arritjen e objektivave të fazës së dytë të tranzicionit. Dhe kjo fazë pritet që të kulmojë me validimin e tri regjimenteve të këmbësorisë së FSK-së të cilat më pastaj do të jenë të gatshme për ta realizuar detyrën kyçe të tyre që është mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit tonë, që të jenë të afta për të realizuar operacione luftarake të fokusuara në mbrojtjen, mësimje dhe stabilitete", ka thënë Maqedonci. Ai ka thënë se pas fazës së dytë, fillon faza e tretë e tranzicionit e cila fillon nga viti 2025, e që përfshin ndërtimin e kapaciteteve

të veçanta për FSK-në, e që janë mbështetja luftarake, mbështetja luftarake në shërbime, mbështetja ajrore si dhe mbrojtja kundër ajrore. Ministri i Mbrojtjes ka thënë se performanca e oficerëve, nënofficerëve dhe ushtarëve të FSK-së si në trajnime, si në programet edukimi ushtarak, e në ushtrime nëpër vendet partnere, është shumë e lartë. Ai ka thënë se pjesëtarë të FSK-së janë duke trajnuar rekrutët ukrainas që janë pjesë e grupit të instruktorëve në operacione "Interflex" në Mbretërinë e Bashkuar.

Rreth 1 mijë e 500 raste të reja me kancer, numri i të rinjve të prekur në rritje

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Rreth 1 500 persona janë diagnostikuar me kancer në nëntëmujorin e këtij viti, duke shënuar rritje prej më shumë se pesë për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Po ashtu, numri i të rinjve të prekur nga kjo sëmundje malinje ka shënuar rritje. Kanceri i gjirit mbetet më i përhapuri te femrat, ndërsa ai i mushkërive vazhdon të dominojë te meshkujt, kështu thotë drejtori i Klinikës së

Onkologjisë pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), Ilir Kurtishi, në një intervistë për "KosovaPress". Kurtishi derisa potencon se numri i të prekurve me kancer po shënon rritje vazhdimisht, thekson se po përballen me mungesë të infermierëve. "Në Klinikën e Onkologjisë janë evidentuar rreth 1 500 raste, që është një numër përafërsisht më i lartë sesa vitin e kaluar. Edhe pse gjatë këtij viti kemi pasur

luhatje në regjistrim ose identifikim të rasteve, tremujorin e parë kishte numër pak më të madh, pastaj numri ka rënë, pastaj kur i kemi grumbulluar të gjitha të dhënat, del që kemi një rritje për këta nëntë muajt e parë diku pesë deri në shtatë për qind sesa vitin e kaluar dhe mbahet trendi i rritjes ose numrit të ri të rasteve të reja, të cilat lajmërohen në Klinikën e Onkologjisë", tha Kurtishi.





Alarmi taktik i Kurtit

Brenda një jave kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka tërhequr vërejtjen së paku dy herë për rrezikun e konflikteve të reja nga Serbia. Pavarësisht prej bisedimeve me vite, Kosova dhe Serbia duket se nuk mund të gjejnë gjuhë të përbashkët. Ato jo vetëm që e kanë të vështirë të komunikojnë, por akuzojnë vazhdimisht njëra-tjetrën se nuk duan paqe

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Pavarësisht prej bisedimeve me vite, Kosova dhe Serbia duket se nuk mund të gjejnë gjuhë të përbashkët. Ato jo vetëm që e kanë të vështirë të komunikojnë, por akuzojnë vazhdimisht njëra-tjetrën se nuk duan paqe. Për presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, autoritetet e Kosovës ushtrojnë "dhunë" ndaj komunitetit serb në veri. Me "lëvizjet arrogante dhe ilegale, Prishtina rrezikon sigurinë e popullatës serbe", ka thënë ai, kur Kosova ka mbyllur disa institucione paralele të

Serbisë në veri të vendit. Brenda një jave, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka tërhequr vërejtjen së paku dy herë për rrezikun e konflikteve të reja nga Serbia. I pyetur nga gazetarët më 17 shtator se si i komenton disa kërkesa të Vuçiqit për serbët e veriut që të riintegrohen në institucionet e Kosovës, Kurti ka thënë se ato "nuk janë racionale". "[Kërkesat e Vuçiqit] nuk janë aspak paqësore por, përkundrazi, janë pjesë e fushatës agresive për konflikte të reja, të cilat padyshim se nuk kanë vend as në Kosovë, as

askund", ka thënë Kurti. Katër ditë përpara kësaj deklarate, Kurti ka bërë një paralajmërim të ngjashëm edhe përmes llogarisë së tij në "Facebook", ku ka siguruar, po ashtu, se Kosova është e gatshme për mbrojtjen e qytetarëve të saj. "Serbia e drejtuar nga ministri i Millosheviqit, në bashkëpunim me Rusinë, po përgatit kërcënime dhe ultimatumë të reja në drejtim të Kosovës... Sot Kosova është më e fortë se kurrë më parë, nuk trembet nga kërcënimet. Ne mbrojmë të gjithë qytetarët tanë dhe liritë e të drejtat e tyre", ka shkruar Kurti. Në frymë të ngjashme është shprehur edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. Por, sipas saj, "asesi" nuk duhet pasur frikë nga Vuçiqi. Me armatimin që ka blerë Kosova dhe me forcimin e përditshëm të institucioneve të

sigurisë, "ne jemi shumë më të fortë seç kemi qenë më parë", ka thënë Osmani më 17 shtator në një adresim para gazetarëve. Më 24 të këtij muaji bëhet saktësisht një vit që kur një grup i armatosur serbësh ka sulmuar policinë e Kosovës në Banjskë afër Zveçanit dhe ka vrarë një polic. Gjatë shkëmbimit të zjarrit që ka pasuar, janë vrarë edhe tre sulmues serbë. Në aktakuzën që ka ngritur Prokuroria Speciale e Kosovës për rastin, thuhet se "grupi, përmes përdorimit të armëve të rënda, ka tentuar ta ndante pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës dhe t'ia bashkonte atë territorit të Republikës së Serbisë". Kurti dhe Osmani, në disa deklarime, e kanë fajësuar direkt udhëheqjen shtetërore të Serbisë për sulmin, edhe pse ajo e ka mohuar. Serbia karakterizohet si "kërcënim kryesor" për sigurinë

e Kosovës edhe në Strategjinë e vendit për Sigurinë për vitet 2022-2027. Kosova dhe Serbia ndajnë një vijë kufitare të gjatë rreth 400 kilometra. Përgjegjës për sigurinë e kufijve të Kosovës me Serbinë është misioni paqeruajtës i NATO-s, KFOR, ndërsa për pjesën tjetër të vijës kufitare është Policia e Kosovës. I kontaktuar nga Radio Evropa e Lirë, KFOR-i thotë se situata në terren është e qetë, por mbetet e brishtë. "Misioni ynë ka një prani të dukshme dhe fleksibile, si dhe është i dislokuar mirë për të adresuar çdo zhvillim të rëndësishëm të sigurisë, në përputhje me mandatin e tij nga OKB-ja. Është e rëndësishme të shmangen veprimet që mund të krijojnë tensione të panevojshme", thotë një zëdhënës i misionit. Ish-zyrtari i NATO-s, Jamie Shea, kujton se KFOR-i, pas sulmit në Banjskë, e ka rritur

Bashkëpunimi rajonal, paralajmërimi gjerman për Kosovën kërkohet të merret seriozisht

Prishtinë, 22 shtator - Paralajmërimet e përfaqësuesve gjermanë ndaj Kosovës për përjashtim nga nismat rajonale nëse nuk zhbllkohet vendimmarrja në CEFTA po kërkohet të merren seriozisht nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Instituti Demokratik i Kosovës. Sipas tyre, Procesi i Berlinit dhe bashkëpunimi rajonal nuk pranon bllokadën tregtare, andaj duhet të merret parasysh kërkesa për heqjen e masave të sigurisë ndaj mallrave serbe. Mirëpo në partinë në

pushtet, Lëvizjen Vetëvendosje, vazhdojnë të insistojnë për nevojën e mbajtjes së këtyre masave, derisa thonë se përjashtimi i Kosovës nga Procesi i Berlinit apo krijimi i ndonjë mekanizmi rajonal pa Kosovën do të nxiste përçarje ndërmjet shteteve në Ballkanin Perëndimor.

Deputetja e PDK-së, Blerta Deliu, thotë për "KP" se qeveria Kurti nuk duhet të sillt me arrogancë karshi kërkesave gjermane për bashkëpunim rajonal. Sipas saj, paralajmërimet e ministres

gjermane për Evropën, Anna Luhrmann dhe emisarit Manuel Sarrazin ndaj Kosovës, duhet të merren seriozisht, në të kundërtën, siç thotë ajo, Kosova rrezikon të mbetet e izoluar në rajon.

Me shqetësim kërcënimit gjerman ndaj Kosovës e sheh edhe Violeta Haxholli nga KDI. Ajo thotë se Gjermania si inicuese e Procesi të Berlinit dëshiron që në samitin e radhës në muajin tetor, të ketë hapa konkretë për tregun e përbashkët rajonal, andaj nuk dëshiron bllokada

tregtare ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, ajo e sheh si të pamundur rikthimin në tavolinë të Ballkanit të Hapur, si nismë për bashkëpunim rajonal. "Procesi i Berlinit nuk e pranon bllokadën tregtare, pasi është në kundërshtim me frymën e procesit të Berlinit dhe marrëveshjen CEFTA-s. Në shumë nene nuk lejohet të ketë bllokadë në produktet e një vendi të rajonit, s'duhet të ketë pengesa në lëvizjen e mallrave në produktet e njëra-tjetres. Procesi i

Berlinit është e vetmja iniciativë zyrtare e pranuar nga Gjermania dhe vendet e rajonit që janë pjesë. Ballkani i Hapur është kundërshtuar nga disa shtete të rajonit, Kosova ka qenë njëra prej tyre që s'e ka pranuar këtë iniciativë. Ajo deri tani, nëse ka filluar të zhvillohet paralelisht me Procesin e Berlinit, nuk ka gjetur përkrahje në mesin e aktorëve ndërkombëtarë. Nuk mund të dimë modalitetet që do të përdoren, por një gjë është e qartë, se duhet të ketë një përkushtim më të madh të vendeve të Ballkanit Perëndimor për t'i zbatuar zotimet që i kanë marrë në kuadër të Procesi të Berlinit", ka deklaruar Haxholli.

Në anën tjetër, deputetja e LV-së, Arbëreshë Kryeziu, thotë se Sarrazin apo kushdo tjetër mund ta kërcënojnë Kosovën për largim nga nismat rajonale, mirëpo një gjë e tillë është e vështirë të ndodhë.

Në prag të samitit të Procesi të Berlinit, i cili do të mbahet më 14 tetor, Gjermania po insiston që Kosova t'i largojë masat e sigurisë ndaj mallrave serbe, të vendosura pas sulmit terrorist serb të 24 shtatorit në Banjskë. Sipas tyre, pas largimit të këtyre masave do të zhblllokohej organizata rajonale CEFTA ku, po ashtu, do të hiqej përfaqësimi i Kosovës nga UNMIK-u.

Qëndrimin e njëjtë e shprehu gjatë kësaj jave edhe ministrja gjermane për Evropë dhe Klimë, Anna Luhrmann, gjatë qëndrimit në Kosovë.



praninë në Kosovë dhe kjo, sipas tij, ka dhënë "shumë mësimë për sigurinë".

Duke folur për programin "Expose" të Radios Evropa e Lirë, Shea thotë se është e rëndësishme që palët të angazhohen në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve. "Mendoj se nuk është në rregull të flitet për kërcënime ushtarake. Unë nuk shoh ndonjë tension të veçantë në kufi. Serbia nuk i ka shtuar trupat e saj në kufi. KFOR-i e ka rritur, po ashtu, praninë në veri të Kosovës, pas sulmit të vitit të kaluar në Banjskë. Pra, marrëveshjet e sigurisë janë të qarta. Unë mendoj se duhet të ndalojmë së foluri për kërcënime dhe të kthehemi në tryezën e bisedimeve", thotë Shea.

Marko Prelec, nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave, vlerëson se situata e sigurisë në Kosovë është stabile. Sipas tij, sulmi në Banjskë ka qenë "zile zgjimi" për rrezikun që mund t'i kanoset veriut të Kosovës, të banuar me shumicë serbe.

Për rrjedhojë, thotë Prelec, është rritur edhe bashkëpunimi mes KFOR-it, por edhe ShBA-së dhe Britanisë me Kosovën, për të gjurmuar dhe parandaluar aktivitetet ushtarake. "Ky lloj i deklaratave [të Kurtit] duhet të merret si përpjekje për ta tërhequr vëmendjen

ndërkombëtare dhe për ta fituar simpatinë ndërkombëtare. Shumica e aleatëve perëndimorë janë të shqetësuar me Rusinë. Dhe për Kurtin, çfarëdo që mund të bëjë për t'u rreshtuar me Perëndimin dhe për ta nxjerrë Serbinë si proruse, duket se ka kuptim", thotë Prelec.

Rusia e mbështet fuqishëm Serbinë në kundërshtimin e pavarësisë së Kosovës, ndërsa edhe vetë e konsideron si "gabim". Ajo shpesh akuzohet për aktivite që ndikojnë gjeopolitikën në përgjithësi në Ballkanin Perëndimor.

Jeta Loshaj, hulumtuese në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë, thotë se Kosova nuk është immune ndaj ndikimit rus. Sipas saj, Rusia, përmes propagandës, lajmeve të rreme, mbështetjes për figura të caktuara qoftë në Serbi, apo në Republikën Sërpska, arrin të depërtojë në Kosovë, në një mënyrë ose tjetër. "Frika për eskalimin e situatës është rritur në tre vjetët e fundit për dy arsye. E para është lufta e plotë që ka nisur Rusia në Ukrainë në shkurt të vitit 2022 dhe e dyta ka të bëjë me aktin terrorist në Banjskë vitin e kaluar". "Kur e dimë që zëvendëskryeministri i Serbisë [Aleksandar] Vulin takohet me [presidentin rus, Vladimir] Putin dhe me udhëheqësit e tjerë të Federatës

Ruse dhe i dimë edhe aspiratat ekspansioniste dhe hegjemoniste të Serbisë në Kosovë, atëherë frika për eskalim sigurisht se ekziston", thotë Loshaj.

Ish-zyrtari i NATO-s, Shea, pranon se Rusia luan rol negativ në rajon, sidomos përmes dezinformimit. Sipas tij, Rusia i shfrytëzon tensionet, andaj mënyra më e mirë për ta reduktuar ndikimin e saj, është ulja e tensioneve, duke i zbatuar marrëveshjet që Kosova dhe Serbia kanë arritur në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve.

Planin e Serbisë për ta rikthyer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, e që ka shkaktuar habinë e disave, Shea nuk e sheh si diçka që do t'i rriste kërcënimet në rajonin e Ballkanit, ku tensionet mbeten të larta që nga shpërbërja e përgjakshme e ish-Jugosllavisë në vitet 1990. "Rekrutët do të shërbejnë vetëm për 75 ditë. Kjo nuk është kohë e mjaftueshme për t'u dhënë atyre ndonjë trajnim serioz ushtarak. Duket se ky rekrutim është më shumë pasojë e pamundësisë për të rekrutuar ushtarë profesionistë në Serbi". "Rreth 12.000 ushtarë profesionistë serbë janë larguar nga forcat e armatosura gjatë dekadave të fundit, për shkak të pagave të dobëta, kushteve të këqija, pajisjeve të dobëta e të

tjera. Pra, duket më shumë si përpjekje për të kompensuar rënien e numrit të profesionistëve", thotë Shea. Serbia e ka hequr shërbimin e detyrueshëm ushtarak në vitin 2011, por Vuçiqi ka miratuar rikthimin e tij më 14 shtator. Kroacia fqinje ka njoftuar, po ashtu, se nisur nga 1 janari i vitit 2025 do ta rikthejë shërbimin e detyrueshëm ushtarak me një kohëzgjatje prej dy muajsh. Prelec, nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave, thotë se qëllim i tyre, mesa duket, është të paraqesin imazhin e një mbrojtjeje të fortë kombëtare. Por, përderisa NATO-ja është aq e pranishme në rajon, është vështirë të imagjinohet ndonjë konflikt i drejtpërdrejtë, sipas tij. Megjithatë, shton se gjërat mund të bëhen më të komplikuar në një afat më të gjatë. "Nëse gjërat qetësohen në Evropë, nëse ka një stabilizim relativisht të shpejtë të situatës në Ukrainë - ndoshta armëpushim, nëse jo marrëveshje paqeje - atëherë mendoj se gjërat do të qetësohen edhe në Ballkanin Perëndimor. Nëse gjërat përshtatëzohen në Ukrainë, ose në ato zhvillohen në favor të Rusisë, atëherë ato mund të kenë efekt shumë destabilizues dhe dëmtes në Ballkanin Perëndimor", thotë Prelec. Për të shmangur rrezikun e tillë,

Loshaj, nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, thotë se përpjekjet e Kosovës dhe të aleatëve të saj perëndimorë duhet të bashkërendohen. "Mendoj që përtej deklaratave dhe vizitave që bëjnë udhëheqësit ndërkombëtarë, duhet të ketë edhe hapa konkretë. Për shembull, nëse Kosova merr Partneritetin për Paqe - që vjen në prag të anëtarësimit në NATO - ky do të ishte një hap pozitiv. Por, mendoj që edhe politikanët tanë duhet të kenë më shumë koordinim, më shumë komunikim, në çfarëdo aspekti, me aleatët e NATO-s dhe të BE-së", thotë Loshaj.

Së paku, BE-ja ia ka bërë të qartë edhe Kosovës, edhe Serbisë se integrimi që synojnë në këtë organizatë, varet nga normalizimi i marrëdhënieve. Por, derisa tensionet mes tyre ziejnë, përparimi duket si një ëndërr e largët.

Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së në dialogun Kosovë-Serbi, Mirosllav Lajçak, ka thënë në një intervistë për Radion Evropa e Lirë më 30 gusht se shoqëritë në këto dy vende nuk janë ende gati për normalizimin.

E, me fjalët e Jamie Sheas, "gjërat mund të lëvizin vetëm me mega-presion ndërkombëtar. Ballkani Perëndimor nuk ka dinamikë autonome".

Shkatërrohet një laborator i dyshuar i kokainës dhe heroinës në Prishtinë

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se gjatë mbrëmjes së 21 shtatorit hetuesit e Njësitit të Anti-drogës kanë mbyllur një laborator të kokainës dhe heroinës në Prishtinë. Sipas njoftimit të policisë, ky aksion erdhi pas një hetimi dhjetëmuor të një laboratorit në rrugën "Hyzri Talla" në Prishtinë. "Dyshohet që ky laborator, për përpunimin e substancave narkotike të llojit heroinë dhe kokainë, është përdorur nga të dyshuarit për një periudhë kohore, ku pas përpunimit të substancave, të njëjtat i paketojnë në doza të vogla për shitje në rajone të ndryshme të vendit", thuhet në njoftimin e policisë.

Për këtë aksion njoftoi edhe ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, i cili tha se ky është laboratorit i 19 i shkatërruar në tre vjetët e fundit, periudhë gjatë së cilës u tha se janë sekuestruar mbi 2 500 kilogramë të llojeve të ndryshme të drogave. "Kjo betejë do të vazhdojë dhe askush nuk do të



jetë i paprekshëm e i fuqishëm para ligjit. Ky fenomen që rrezikon jetën e fëmijëve e rinisë sonë dhe që shkatërron harmoninë në familjet e vendit tonë do të goditet në vazhdimësi dhe pa mëshirë nga ana jonë", ka

shkruar Sveçla në "Facebook". Aksione të tilla janë raportuar edhe në të kaluarën. Në maj të vitit 2022 Policia e Kosovës kishte shkatërruar dy laboratorë të drogës - një në veri të Kosovës dhe një në Ferizaj. Gjatë atij

aksioni ishte zbuluar një laborator i kultivimit të marijuanës me mbi 10 000 fije bimë "të gatshme për t'u shitur ilegalisht në treg", kishte thënë Sveçla në atë kohë.

Brenda gjashtë muajve të vitit

2023 nga përdoruesit e substancave narkotike janë konfiskuar rreth 5 gramë heroinë, rreth 58 gramë kokainë dhe rreth 1 kg marijuanë. Në të njëjtën periudhë, sipas saj, nga trafikuesit e substancave narkotike në tërësi janë konfiskuar rreth 2.6 kg heroinë, 4.6 kg kokainë, rreth 303 kg marijuanë, 3.5 kg hashash, rreth 1 kg ekstazi, mbi 1.100 bimë kanabisi, 3 mililitra vaj kanabisi, 120 gramë amfetaminë dhe rreth 2 kg droga të tjera.

Ndërkaq, për veprat penale "blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge", si dhe për "kultivimin e bimës së hashashit, shkurrës së kokainës ose bimëve të kanabisit", policia "ka hapur 291 raste dhe ka arrestuar 387 persona".

Me Kodin Penal të Kosovës është e jashtëligjshme që qytetarët të blejnë, posedojnë apo shpërndajnë substanca narkotike. Ata mund të dënohen me gjobë apo burgim, varësisht nga sasia dhe lloji i lëndës narkotike që iu kapet nga autoritetet e rendit.

26 vjet nga rënia e heronjve Fehmi dhe Xhevë Lladrovci dhe dëshmorëve të tjerë



EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Të dielën janë bërë 26 vjet nga rënia heroike e komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fehmi Lladrovci, bashkëshortes së tij, heroinës Xhevë Krasniqi-Lladrovci dhe dëshmorëve Behxhet Karaxha, Milazim Karaxha, Hamit Lladrovci, Fatime Hetemi dhe Shefqet Zeka.

Për të nderuar të rënë në këtë ditë, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me stafin e tij, deputetë të Kuvendit të Kosovës, kryetarë të komunave, shkrimtarë, shoqata të dala nga lufta e UÇK-së, personalitete nga jeta

publike dhe politike dhe qytetarë, kanë bërë homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Gllanasellë dhe kanë vendosur buqeta me lule të freskëta.

Edhe pushteti dhe opozita e kanë përkujtuar Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin në 26-vjetorin e rënies.

Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Xhevë dhe Fehmi Lladrovci janë gardianët e përjetshëm të lirisë dhe Republikës së Kosovës. "Sot shënojmë 26-vjetorin e rënies heroike të dy gjigantëve të historisë së kombit tonë, të cilët sakrifkuan gjithçka për lirinë që kemi sot. Ata ranë së bashku pikërisht në këtë ditë, të bashkuar edhe në përkushtimin e palëkundur për çlirimin e

Kosovës. Xheva dhe Fehmiu ishin më shumë se luftëtarë - simbole të shpresës dhe forcës për të gjithë ata që ëndërruan dhe dëshiruan një Kosovë të lirë dhe të pavarur. Trashëgimia që kanë lënë pas Xheva dhe Fehmiu i tejkalon kohët. Ata kurorëzuan veprimtarinë e tyre patriotike me aktin e heroizmit të rënies në krye të betejës. Në çdo cep të Kosovës ndihet sakrificat e tyre - në lirinë që jetojmë, në shtetin që kemi ndërtuar dhe në shpresën për një të ardhme më të ndritur", ka thënë Osmani në deklaratën për medie.

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se jeta e tyre ishte lavd për dashurinë, lavd për dashurinë për lirinë, lavd për

dashurinë për lirinë e Kosovës. "Lavdi Fehmi Lladrovci dhe Xhevë Krasniqi - Lladrovci, të rënë heroikisht, këtu e 26 vjet më parë!", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Edhe lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka përkujtuar Fehmi dhe Xhevë Lladrovci. "Për ta më e shtrenjtë ishte liria sesa jeta. Për të parën do të vdisnin me një buzëqeshje në fytyrë - sepse e dinin se kjo ishte rruga e vetme drejt nderit dhe përjetësisë. Përgjithmonë mirënjohës ndaj tyre dhe mijëra burrave e grave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që me sakrificë e vetëmohim, u bënë themel i horizontit të lirisë dhe shtetit tonë sovran", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Fehmi dhe Xhevë Lladrovci ishin themelartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishin shembull i pastër i idealit të luftëtarëve të lirisë. "Ata u përballën bashkë me çdo sfidë, duke qëndruar të palëkundur deri në rënien e tyre heroike", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin e ka përkujtuar edhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i cili ka thënë se jeta dhe vepra e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci në shërbim të vendit, ishte dhe do të mbetet gjithnjë frymëzim ndër breza, si shembulli më i mirë i përkushtimit dhe sakrificës për liri dhe pavarësi.

Zero taksa për regjistrimin e veturave elektrike. A mjafton?



PRISHTINË, 22 SHTATOR - Përdoruesit e veturave elektrike në Kosovë pritet të mos paguajnë taksë të regjistrimit meqë nuk e ndotin ambientin. Ky lehtësim është paraparë të përfshihet në Projektligjin për Automjete, për ndryshimet e të cilit u vendos në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës mbajtur me datë 28 gusht.

Nëse importojnë vetura elektrike, shoferët “do të kenë zero taksa të regjistrimit”, thanë shkurtimisht për Radion Evropa e Lirë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Kosovës (MMPHD), institucion ky që është duke punuar në ndryshimet në projektligj.

Në deklaratën e dërguar me shkrim nuk saktësohet se për cilat taksa bëhet fjalë e as sa mund të jetë vlera financiare e tyre.

Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se në tre vjetët e fundit në Kosovë janë importuar 585 vetura elektrike.

Automjetet elektrike lëvizin nga një ose më shumë motorë elektrikë, që përdorin vetëm energjinë e ruajtur në bateri.

Vitet e fundit jo rrallëherë në Prishtinë has në kësi lloj veturash. Ato i përdorin kryesisht kompanitë e taksive dhe bizneseve të tjera private. Për afaristët dhe përfaqësuesit e komunitetit të biznesit, masat lehtësuese të paralajmëruara

nga qeveria janë të pamjaftueshme.

“Masa jofavorizuese”

Sipas tyre, taksat e regjistrimit të veturave elektrike sillen nga 75 deri në 105 euro.

Aktualisht importi i automjeteve elektrike është i njëjtë me importin e veturave me karburante të naftës apo benzinës.

Nëse importohet një veturë qoftë me djegie të brendshme apo elektrike duhet të paguajë doganë prej 10 % të vlerës së makinës si dhe tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSh) që është 18 % e vlerës së produktit. E në rastet ku importohen vetura të përdorura, qoftë elektrike apo me naftë e benzinë, atyre u shtohet edhe taksa e akcizës, e cila zbatohet për produktet që nuk janë esenciale për jetesën e qytetarëve.

Në Doganën e Kosovës thonë se për veturat deri në tetë vjet të vjetra duhet paguar 400 euro për copë; deri në nëntë vjet - 600 euro dhe deri në dhjetë vjet - 700 euro.

Pronarët duhet të paguajnë edhe taksat administrative, rrugore, ekologjike dhe komunale në qendrat për automjete që funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

MPB-ja nuk iu përgjigj pyetjes së

REL-it se sa kushtojnë këto taksa. Pronari i një kompanie të sigurimeve, që kryen procedurat e regjistrimit të automjeteve për qytetarë, tregon për Radion Evropa e Lirë se “këto taksa kushtojnë 75 euro - plus tri euro shërbime bankare”. E nëse vetura regjistrohet për herë të parë në Kosovë, 20 euro duhet paguar për targa dhe 10 euro për librezën e veturës.

Kërkohet heqja e taksës doganore dhe e TVSh-së

Fidan Hallaqi, pronar i kompanisë së taksive ETAXI, e cila operon me disa vetura elektrike, thotë se këto taksa nuk janë ndonjë barrë e madhe. Sipas tij, blerja e veturave elektrike do të bëhej e leverdishme nëse do të hiqeshin taksa doganore dhe TVSh-ja.

Hallaqi, i cili në vitin 2021 ka blerë 20 vetura elektrike për kompaninë e tij, thotë se do ta shtonte numrin e tyre po të kishte lehtësira të tilla doganore. “Mbi 280 mijë euro kam paguar vetëm taksë doganore dhe TVSh për 20 vetura. Kjo shumë është e lartë”, thotë ai. “Këto vetura nuk lirojnë as gaz e as grimca në ajër gjatë lëvizjes dhe për këtë duhet të subvencionohen dhe jo të pengohen”, shton Hallaqi.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, shpreh mendim të ngjashëm.

“Kur qytetari blen një veturë mbi 20 mijë euro, e cila ruan ambientin, heqja vetëm e taksës së regjistrimit është qesharake”, sipas tij.

OEK, thotë ai, kërkon nga Qeveria e Kosovës që për veturat elektrike të hiqen taksa doganore dhe TVSh-ja, ose TVSh-ja të mos paguhet 18 për qind, por 8 për qind.

“Në këtë mënyrë do të stimuloheshin edhe qytetarët, edhe kompanitë private që të investonin në makina elektrike, rrjedhimisht në ruajtje të ambientit”, thotë Rafuna për Radion Evropa e Lirë.

Në Koncept-dokumentin për fushën e automjeteve të publikuar vitin e kaluar nga Ministria e Infrastrukturës, thuhet se favorizimi i makinave elektrike me zero taksa për regjistrim “ndikon në mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e ajrit”.

Në Strategjinë për Energjinë, ndërkaq, thuhet se deri në vitin 2031 pritet që numri i veturave elektrike në Kosovë të mbërrijë rreth 15 000.

Ambientalistët thonë se transporti rrugor është një nga burimet më të mëdha të ndotjes së ajrit në Kosovë. “Kontribuesja më e madhe është industria prodhuese, pasuar nga ngrohjet individuale gjatë sezonit të dimrit dhe veturat me djegie të naftës dhe benzinës”, thotë Agron Bektashi, njohës i çështjeve të mjedisit dhe

ish-drejtor i Qendrës Rajonale të Mjedisit, për Radion Evropa e Lirë.

Për ta përmirësuar cilësinë e ajrit, e cila përkeqësohet gjatë çdo sezoni dimëror, ai thotë se qeveria duhet të gjejë buxhet që t'i subvencionojë veturat elektrike.

Për këtë qëllim edhe disa banka komerciale në Kosovë, ashtu si edhe Kompania për Distribuimin e Energjisë Elektrike (KESCO), kanë futur në përdorim veturat elektrike.

Në shtatë qytetet më të mëdha të Kosovës KESCO ka vendosur edhe prizat për mbushje të këtyre veturave.

Derisa në Kosovë vazhdon puna në Projektligjin për Automjete, disa vende të rajonit kanë filluar tashmë prej vitesh zbatimin e masave lehtësuese për veturat elektrike.

Shqipëria, për shembull, ka marrë vendim qysh në vitin 2020 që ta heqë pagesën e TVSh-së për këto vetura.

Në shtetet e Bashkimit Evropian, ndërkaq, përdorimi dhe adoptimi i automjeteve elektrike po vazhdon me ritëm të shpejtë. Në vitin 2023, 1.5 milion makina elektrike u regjistruan për herë të parë në BE, duke e çuar numrin total në 4.5 milionë.

Shifra paraqet 48.5 % rritje krahasuar me vitin 2022, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave, Eurostat.

Pse Perëndimi nuk mund ta bëjë Rusinë të dështojë (nafta ka të bëjë me të)

Pse vala e sanksioneve që synon dobësimin e Moskës nuk po ndikon në ekonominë ruse? Pyetja intensifikohet, veçanërisht kur lufta në Ukrainë intensifikohet.

Pavarësisht kufizimeve të eksportit, ngrirjes së aseteve dhe një ekonomie të shkëputur nga sistemi financiar global, Kremli nuk e lë të lirë dhe vazhdon sulmet e tij kundër Kievit. Jo vetëm që lufta po vazhdon dhe tashmë është e qartë se do të ketë një zgjerim të frontit, por edhe ekonomia ruse është në gjendje të shkëlqyer shëndetësore.

Sipas analistëve, ne duhet të shohim se ku kanë goditur sanksionet: fort në sektorin e gazit, "butë" në sektorin e naftës. Pse?

Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj perëndimorë e dinë mirë se Rusia mbetet ende një lojtar thelbësor në tregun global të energjisë. Rënia e tij do të nënkuptonte çmime më të larta të energjisë për të gjithë, duke rezultuar në një recesion që mund të pushtojë edhe tregjet e tyre. Rezultati: ekonomia ruse mbetet solide dhe Presidenti Vladimir Putin mund të vazhdojë të investojë në armë me një perspektivë anti-ukrainase.

Aftësia e Rusisë për t'u përshtatur sanksioneve

Për këtë vit Fondi Monetar Ndërkombëtar ka parashikuar rritje ekonomike për Rusinë prej 3.2%. Shumë produkte

perëndimore, pavarësisht sanksioneve, vazhdojnë të mbërrin në supermarketet ruse përmes rrugëve të reja tregtare që synojnë anashkalimin e kufizimeve. Moska më pas bëri përpjekje për të prodhuar vetë disa mallra që nuk mund të kalojnë kufijtë në anën e Bashkimit Evropian. Kur dyert u mbyllën në anën e 27 shteteve të bllokut të BE-së dhe SHBA-së, aftësia e Kremliut ishte të shikonte diku tjetër, duke hyrë shpejt në tregjet e Afrikës, Azisë dhe Amerikës Latine, si për të gjetur lëndë të para dhe për të vendosur produktet e tij.

Prandaj, izolimi i Vladimir Putin është vetëm pjesërisht i vërtetë. "Duket se ekonomia ruse ka arritur të përshtatet me kushtet e jashtme shumë të pafavorshme", tha për BBC Yevgeny Nadorshin, ekonomist i lartë në PF Capital. "Pa dyshim që sanksionet kanë thyer shumë në mekanizmin funksional brenda ekonomisë, por shumë janë rikthyer", shtoi eksperti.

Sanksione të dobëta ndaj naftës ruse

Sanksionet nuk hyjnë në fuqi menjëherë dhe nuk dihet me siguri se si do të mund të reagojë një vend që i vuan ato. Rusia ka treguar se ka qenë në gjendje të gjejë një alternativë. Si? Eksportet ruse të naftës kanë marrë rrugë të ndryshme. Duke mos qenë më në gjendje të rrjedhin drejt Evropës, Moska i dërgoi ata drejt



Kinës dhe Indisë. Përballë kësaj kthese, në dhjetor 2022, udhëheqësit e G7 dhe BE-së prezantuan një plan kapitalizimi të çmimeve për të kufizuar të ardhurat që Rusia fiton nga eksportet e naftës së papërpunuar.

Paralajmërimi i SHBA për Kievin: "Mos prek naftën ruse"

Qëllimi ishte mbajtja e çmimeve për fuçi nën 60 dollarë. Kjo zgjidhje gjithashtu doli të ishte pjesërisht joefektive. Kufiri uli të ardhurat, por nafta ruse vazhdoi të vërshonte tregun global, kryesisht në avantazh të

Pekinit. Pse? Sipas Financial Times, Presidenti i SHBA Joe Biden i tha shprehimisht Kievit të mos sulmonte infrastrukturën ruse të naftës për të parandaluar rritjen e çmimeve të naftës së papërpunuar. Ka nga ata që theksojnë se Rusia u godit qëllimisht, por nuk u fundos.

Rreziku i recesionit nëse Rusia fundoset

"Sepse Evropa ka zgjedhur të mos e lërë të shembet, për të mos na tërhequr ne dhe botën në recesion. Thjesht merrni bursën dhe krahasoni se si po shkon në Moskë për gazin

(shumë keq, linjë blu) dhe për naftën (mirë, vija e kuqe)", ka shkruar Matteo Villa, i cili drejton DataLab të Institutit Italian të Studimeve Politike Ndërkombëtare (ISPI), në X.

"Rreth dy të tretat e të ardhurave nga karburantet fosile vijnë nga nafta, jo gazi", shtoi Villa.

"Në një farë kuptimi, ne kemi refuzuar të sanksionojmë siç duhet naftën ruse", tha për BBC Elina Ribakova, një studiuese e tregjeve globale në Institutin Bruegel në Bruksel.

Rreth dy të tretat e shitjeve të karburanteve fosile të Rusisë sot vijnë nga nafta. Kjo do të thotë se rruga për dobësimin e Putinit është ende qartësisht e përpjetë.

SHBA, lufta kundër lajmeve të rreme drejtuar komunitetit hispanik

Popullsia hispanike në Shtetet e Bashkuara mbështetet tek mediat sociale për t'u informuar. Siç njofton korrespondentja e Zërit të Amerikës, Cristina Caicedo, dezinformatat në mediat sociale përhapen me shpejtësi. Redaksitë e lajmeve dhe nismat mediatike po përpiqen të gjejnë mënyra të reja për të luftuar përhapjen e lajmeve të rreme dhe për të mirinformuar publikun në prag të zgjedhjeve amerikane të nëntorit.

Në Shtetet e Bashkuara, mediat hispanike të lajmeve po përpiqen të luftojnë lajmet e rreme dhe t'u shpjegojë komuniteteve se si dhe ku të votojnë.

"Këtë vit zgjedhor njerëzit po kërkojnë të jenë më të informuar dhe kanë shumë pyetje. Kur ndajmë një lajm, gjithmonë kemi pyetje në lidhje me të", thotë Claudia Ginestra me gazetën javore "El Tiempo Latino" që publikohet në kryeqytetin amerikan.

Gazeta raporton lajme që prekin



interesat e komunitetit hispanik dhe shfrytëzojnë rrjetet sociale për të komunikuar me audiencën. "Aktualisht, videot e shkurtra që postojmë po tërheqin shumë njerëz. Kjo është mënyra më e shpejtë dhe e efikase për të komunikuar me audiencën", thotë për Zërin e Amerikës gazetarja Claudia Ginestra. Anketat e Qendrës Kërkimore Pew tregojnë se hispanikët

informohen kryesisht përmes internetit dhe mediave sociale. Ata përdorin aplikacionet WhatsApp, Telegram dhe Instagram, sipas kompanisë mediatike Nielsen.

Për t'i ofruar komunitetit informacionin që u nevojitet, gazeta "El Tiempo Latino" përdor mjete të kontrollit të fakteve ose kërkon ndihmën e organizatës partnere "Factchequeado".

E themeluar në vitin 2022, organizata jofitimprurëse vëzhgon keqinformimin dhe dezinformatat e lajmeve në komunitetin latin dhe hispanik në Shtetet e Bashkuara.

"Ndërsa afrojnë zgjedhjet e nëntorit, komuniteti përballet me shumë sfida. Po ashtu, edhe ne që përpiqemi t'i informojmë ata kemi shumë sfida", thotë themeluesja e organizatës "Factchequeado" që kontrollon faktet, Laura Zommer.

Një prej sfidave është edhe intelijenca artificiale.

"Për shembull, në TikTok shohim që një video publikohet me një lajm dezinformues dhe më pas shohim dy video të tjera me të njëjtin lajm nga përdorues të ndryshëm, por që thonë të njëjtën gjë", tregon zonja Zommer.

Keqinformimi synon përhapjen e lajmeve të rreme.

"Një lajm i rremë që përhapet shumë është teoria konspirative që pretendon se jo shtetasit amerikanë po votojnë".

Shpejtësia është çelësi për të

luftuar përhapjen e lajmeve të rreme, të cilat përhapen me nxitim në mediat sociale, thotë zonja Zommer.

Por organizata "Factchequeado" ka në dispozicion një mjet të fuqishëm, bashkëpunimin me dhjetëra partnerë në 22 shtete. Redaksitë e lajmeve si "El Tiempo Latino" përdorin organizatën "Factchequeado" për të verifikuar të dhënat.

"Komuniteti hispanik nuk po informohet sa duhet ose po keqinformohet kur bëhet fjalë për politikën. Por ne po shohim që audienca jonë kërkon të informohet dhe të mësojë", thotë Marcos Porras me gazetën "El Tiempo Latino".

Mes të tjerash, gazeta poston në median sociale video shpjeguese mbi procesin zgjedhor në Shtetet e Bashkuara. Synimi është për të plotësuar mungesën e të dhënave që mund të shfrytëzohet nga elementë negativë për të përhapur lajme të rreme apo dezinformata.

Rikthim në origjinë të Covid-it: Çfarë dijmë dhe çfarë duam të dijmë

Kohët e fundit, interesi rreth Covid-19 është rritur sërish për shkak të rasteve dhe zbulimeve të reja. Variantet e reja të virusit jo vetëm që vazhdojnë të përhapen mes njerëzve, por janë gjetur edhe te kafshët shtëpiake, si qentë, duke nxitur shqetësimet për mënyrat e reja të transmetimit. Origjina e tij, megjithatë, mbetet në qendër të debatit.

Megjithëse virusi u zbulua për herë të parë në Wuhan të Kinës, origjina e tij është ende e pasigurt. Ka pasur teori të ndryshme për këtë çështje: ka nga ata që kanë argumentuar se fajin e kishte tregtia e kafshëve të egra, nga ata që pohojnë se viruset krijohen në laboratorë për të përgjysmuar popullatën, apo edhe se kjo është për shkak të mungesës së higjienës të disa popullatave.

Ndoshta, siç ndodh shpesh, përgjigja qëndron diku në mes. E sigurt është se viruset shpesh “lindin” në Kinë, nga gripi aziatik i vitit 1957 deri tek gripi i Hong Kongut i vitit 1968, duke kaluar përmes SARS-it dhe padysim Coronavirusit, dhe ka një arsye. Nëse nuk mund të marrim një përgjigje të qartë se si lindi ky e fundit, kjo ndodh sepse nuk ka siguri. Megjithatë, është e mundur të shqyrtohen faktorët që mund të kenë kontribuar në lindjen e Covid dhe të ndiqen rezultatet e kërkimit shkencor.

Faktorët sociokulturorë

Shumë studime mbi epidemitë e SARS tregojnë se faktorët socialë dhe kulturorë, si tregtia dhe konsumi i kafshëve të egra dhe kushtet e këqija sanitare, rrisin rrezikun e transmetimit të virusit nga kafshët te njerëzit. Këto aktivitete, veçanërisht në vendet tropikale, favorizojnë kontaktin midis specieve të egra, dhe bashkëjetesa e detyruar në kushte stresuese krijon kushtet për shfaqjen e varianteve të reja. Covid-19 është në fakt i ngjashëm me virusin e lakuriqëve të natës dhe dyshohet se një kafshë e ndërmjetme, si macja civet, pangolina ose qeni i rakunit, i siguron virusit aftësinë për të mutuar dhe lehtësuar transmetimin te njerëzit. Përzierja e kafshëve dhe guetia e specieve të egra përfaqëson një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin publik, pasi këto kafshë strehojnë viruse si SARS, Ebola dhe tërbimi.

Në fakt prej vitesh janë bërë studime për rëndësinë e menaxhimit të trafikimit të paligjshëm dhe jo të paligjshëm të kafshëve në kushte stresuese. Duke përjashtuar implikimet etike, arsyeja kryesore është mundësia e kontaktit me infeksione me origjinë shtazore të cilat mund të jenë të dëmshme për njerëzit, duke



favorizuar shfaqjen e sëmundjeve të mundshme zoonotike.

Nga lakuriqi i natës, te njeriu

Shkencëtarët kanë zbuluar bashkëjetesën e SARS-CoV shumë të ndryshme në popullatat e lakuriqëve të natës në një shpellë në provincën Yunnan, Kinë. Ndër studimet më të famshme janë ato të kryera nga Shi Zhengli, e njohur si “Batwoman”, një virologe e specializuar në studimin e gjenomit të lakuriqëve të natës dhe drejtuese e Qendrës së Sëmundjeve Infektive të Institutit Wuhan.

Studimet e saj mbi SARS-in kanë treguar, falë ekspeditave brenda shpellave kryesore kineze që strehojnë kolonitë e lakuriqëve të natës, se ato në provincat e Guangdong, Guangxi dhe Yunnan kanë rrezikun më të madh për të qenë koronaviruset që transmetohen te njerëzit nga kafshët, veçanërisht nga lakuriqët.

Fakti që virusi CoV-19 i ngjan një virusi të lakuriqëve të natës, por është, ndryshe nga shumica ekzistues në natyrë, i aftë të infektjë njerëzit, ndoshta është për shkak të një mutacioni, falë kalimit nga lakuriq nate te një kafshë tjetër te njeriu. Analiza bioinformatike sugjeroi gjithashtu se kishte tashmë disa ngjarje të transmetimit të CoV midis lakuriqëve të natës, maceve civet dhe njerëzve përpara epidemisë SARS të vitit 2002.

Ndër hipotezat mendohet se paraardhësi i drejtpërdrejtë i

SARS-CoV u prodhua nga rikombinimi brenda lakuriqëve të natës dhe më pas u transmetua te civetat e kultivuara, gjatë me origjinë nga Azia tropikale dhe subtropikale dhe Afrika, në të cilët ishin gjetur shtama SARS-CoV.

Kur macet civet të infektuara me virus u transportuan në tregun e Guangdong, virusi u përhap në treg dhe pësoi mutacione të mëtejshme, përpara se të përhapej te njerëzit. Megjithatë, mutacioni mund të ketë ndodhur brenda kafshëve të tjera, të tilla si pangolinët, në të cilat janë gjetur forma të ngjashme virale. Pangolina përdoret për qëllime ushqimore dhe në farmakopenë tradicionale të vendit dhe kjo do të shpjegonte mënyrën se si kaloi nga kafsha te njeriu.

Qentë rakun, të shitur gjithashtu në tregjet e Wuhan, janë identifikuar kohët e fundit si ndërmjetës të mundshëm. Nuk ka siguri se cila kafshë e ndërmjetme e shkaktoi mutacionin që më pas arriti te njeriu dhe pak rëndësi ka se cili ishte shkak, kur në realitet faji duhet t’i atribuohet më shumë veprimit njerëzor. Mënyra më efektive për të parandaluar zoonozën virale është ruajtja e barrierave midis rezervuarëve natyrorë dhe shoqërisë njerëzore, duke marrë parasysh konceptin “Një Shëndet”, i cili njeh shëndetin e njeriut si të lidhur ngushtë me shëndetin e kafshëve dhe gjendjen mjedisore në të cilën jetojmë të gjithë.

Dihet se në këto tregje shiteshin kafshë të gjalla, që i përkisnin specieve të kultivuara, por edhe të kapura nga mjedisi i tyre natyror. Kina fillimisht i ndalo

përkohësisht këto aktivitete pas epidemisë, por tregjet janë ende të hapura për publikun, pavarësisht se autoritetet kineze mohojnë se janë shitur kafshë të gjalla, veçanërisht në lidhje me tregun e Wuhan.

Testimi i kafshëve në Kinë

Një faktor për të cilin ne rrallë dëgjojmë dhe që mund të ketë kontribuar potencialisht në shfaqjen e varianteve të virusit është testimi i kafshëve. Eksperimentimi i kafshëve në Kinë ka origjinë të lashtë, që daton që nga dinastia Tang (618-907), me farmakologun Chen Zangqi, i pari që e përdori atë. Në vitin 1918, Qi Changqing vazhdoi me teste në minj, ndërsa nga viti 1946, pas Luftës së Dytë Botërore, praktikat rinisën intensivisht.

Me themelimin e Republikës Popullore të Kinës në vitin 1949, eksperimentet vazhduan, veçanërisht në Pekin dhe Shanghai. I ndërprerë gjatë Revolucionit Kulturor (1966-1976), eksperimentimi rifilloi në 1987 me krijimin e Shoqatës Kineze për Shkencën Laboratorike të Kafshëve. Rregullorja e parë për kafshët laboratorike daton në vitin 1988 dhe, pavarësisht rregulloreve të reja, praktika mbetet e përhapur. Statistikat nga Ministria e Shkencës dhe Teknologjisë tregojnë se çdo vit rreth dymbëdhjetë milionë kafshë përdoren në Kinë për qëllime shkencore të kërkimit mjekësor, duke përfshirë minjtë, lepujt, derrat, qentë dhe primatët. Për më tepër, ka edhe institucione

dhe universitete të huaja që “transportojnë” testimin e kafshëve në Kinë që të mund të eksperimentojnë më lirshëm.

Shumë shpesh injorohet se rreziqet e mundshme të pandemive që vijnë nga patogjenë të panjohur vijnë gjithashtu nga një sektor specifik i kërkimit shkencor, i quajtur Gain of Function (GoF). Kjo e fundit konsiston në prodhimin e mutacioneve që përcaktojnë një “fitim funksioni”, domethënë modifikojnë gjenomën e viruseve të pranishme në kafshë në natyrë, në një përpjekje për të parashikuar mutacionet e ardhshme dhe për të kuptuar nëse ato mund të çojnë në kërcime të specieve nga kafshët te njerëzit, dhe sa efikase mund të jenë në transmetimin në popullatën njerëzore.

Praktika është shumë e diskutueshme, si për shkak të rrezikut të krijimit të patogjenëve të rinj në laborator dhe mungesës së transparencës dhe kontrollit nga ana e shoqërisë civile. Pikërisht në Wuhan ka një laborator të biosigurisë dhe patogjenëve të veçantë ku kryhen studime dhe eksperimente. Nuk është për t’u habitur që shkenca përdor këto metoda kërkimore, në shumë raste ato janë në fakt themelore. Por gjithmonë ekziston një rrezik. Një rrezik i llogaritur mirë, i parashikuar dhe i injoruar qëllimisht. Shkenca, evolucioni, teknologjia janë lojëra fati: rreziku i dëmtimit afatgjatë është shumë i madh, por adrenalina që gjeneron fuqinë për të krijuar, për të luajtur Zotin, është shumë më e lartë dhe shpesh ia kalon çdo gjëje tjetër. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Milani regjistron fitore spektakolare në derbin ndaj Interit

MILANO, 22 SHTATOR - Në momentin më të vështirë të sezonit Milani "zgjohet" dhe merr një fitore spektakolare 2-1 ndaj Interit në Derbin e Madoninës. Skuadra e Fonseca-s për herë të parë këtë sezon zhvillon një

ndeshje shumë të mirë duke marrë dhe pikët e plota. Në minutën e 10-të, Pulisiq shënoi një gol shumë të bukur me një aksion personal duke dribluar thuajse gjithë mbrojtjen zikaltër. Kundërpërgjigja e

zikaltërve erdhi në mesin e pjesës së parë me Dimarcon që barazoi me një të majtë të saktë brenda zonës nga një pozicion i prirët. Inter luajti më mirë në 45 minutat e para, ndërkohë që në të dytën ishte Milan që rrezikoi

në disa raste, por Sommer i mohoi gola të sigurt. Gjithsesi një minutë nga fundi i kohës së rregullt, Gabbia shënoi me kokë golin e fitores. Tashmë të dyja skuadrat kanë nga 8 pikë pas 5 javësh.



Kastrioti lufton deri në fund, por megjithatë eliminohet



Ferizaj, 22 shtator - Ndonëse luftuan deri në fund, lojtarët e Kastriotit janë mposhtur me katër gola dallim nga Slloboda e Tuzllës. Kështu rrugëtimit të skuadrës ferizajase në Kupën Evropiane i erdhi fundi. Një javë më parë në Ferizaj, Kastrioti kishte fituar me rezultat 30:29. Por të dielën në Tuzëll, pësoi me rezultat 32:28. Kastrioti

eliminohet në raundin e parë të Kupës Evropiane. Skuadra ferizajase megjithatë largohet nga garat evropiane në mënyrë të dinjitetshme. Luftoi deri në fund me skuadrën boshnjake që edicionin e kaluar arriti deri në një të tetën e finales të Kupës Evropiane. Kastrioti ishte në epërsi 15:13 pas pjesës së parë të ndeshjes. Në

pjesën e dytë lojtarët e skuadrës boshnjake shfaqën pak më shumë dhe fituan në fund me rezultat 32:28. Deniz Terziqi i realizoi nëntë gola për Kastriotin. Shtatë i kishte Lulzim Shabani, ndërsa Rron Ramadani e Beni Sula i shtuan nga katër. Liridon Esati i kishte dhjetë pritje. Kastrioti tani vazhdon garat vendore me synim për suksese të reja.

Bashkimi me fitore bindëse kundër Vëllaznimit



PRIZREN, 22 SHTATOR - Bashkimi ka shënuar fitoren e parë në këtë edicion të ProCredit Superligës. Prizrenasit fituan ndaj Vëllaznimit me rezultat 72:51 (18:15, 15:3, 21:7, 18:26). Çereku i parë ishte kryesisht i baraspeshuar, duke përfunduar 18:15 për vendasit, të cilët shkëlqyen në periudhën e dytë,

derisa mysafirët për dhjetë minuta shënuan vetëm tri pikë. Portokallezjinjtë ishin bindshëm më të mirë edhe në periudhën e tretë, 21:7, ku shifrat pas 30 minutash ishin 54:25. Dhjetë minutat e fundit më shumë ishin formale, me Bashkimin që fitoi në fund 72:51. Kjo ishte fitorja e parë për Bashkimin në ndeshjen e

parë në këtë edicion, derisa Kuqezinjtë kanë një fitore e një humbje. Te vendasit u dalluan Jayveous Mckinnis me nëntë pikë e shtatë kërcime, Mack Smith me 12 pikë dhe Maliek White me 13 pikë, kurse dy të dalluarit te mysafirët ishin Shizz Alston me 22 pikë dhe Trey Anderson me 16 pikë e pesë kërcime.

Fitojnë Drita dhe Malisheva

GJILAN, 22 SHTATOR - Drita ka shënuar fitore në derbin e javës së 6-të në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra gjilanase arriti ta mposhtë kampionin në fuqi, Ballkanin, me rezultat 1:0. Goli i vetëm i ndeshjes u shënuar nga Albert Dabiqaj, në minutën e 83-të. Me këtë fitore Drita ngjitet në pozitën e 6-të, me 9 pikë, por ka dy ndeshje më pak të zhvilluara. Edhe në ndeshjen tjetër fitoresiu gëzua skuadra vendase, ku Malisheva e mposhti Gjilanin,

me rezultat 2:1. Malisheva e nisi ndeshjen me një penallti të shndërruar në gol nga Vesel Limaj, në minutën e 21-të. Gjilani reagoi shpejt dhe barazoi rezultatit me golin e Edi Basha, në minutën e 44-t. Megjithatë, Laurent Xhylani shënoi golin e fitores për Malishevën në minutën e 52-të, duke i siguruar kështu tri pikët e plota. Kjo fitore e vendos Malishevën në pozitën e dytë, me 13 pikë, aq sa ka edhe Suhareka që kryeson renditjen.



City shmang në fund humbjen ndaj Arsenalit

MANCHESTER, 22 SHTATOR - Manchester City dhe Arsenal barazojnë 2-2 në "Etihad", në ndeshjen e vlefshme për Premier Ligë. Goli i parë i takimit erdhi në minutën e 9-të. Savinjo shërbeu për Haaland, me sulmuesin norvegjez që nuk mund të gabonte nga ai pozicion.

Londinezët nuk e kishin ndërmend të dorëzoheshin dhe u futën në lojë në minutën e 22-të. E majta e Calafiorit ishte e pamundur për t'u arritur nga Ederson. Në fundin e pjesës së parë, ekipi i Artetës përmbys llogaritë. Gjithçka nis nga ekzekutimi i një goditje këndi,

me mbrojtësin brazilian Gabriel që shënon me kokë. Pjesa e parë do mbyllet me thriller për Arsenal. Në të 52-tën, Trosard tregohet naiv, duke marrë kartonin e dytë të verdhë dhe duke lënë Guners me një lojtar më pak. Në pjesën e dytë, skuadra e Guardiola's u hodh e gjitha në

sulm, në kërkim të golit të barazim. Gjithsesi, pavarësisht superioritetit numerik, kampionët e Anglisë hasën vështirësi në finalizimin e rasteve. Në kohën shtesë, Stons shmangi disfatën e vendasve. Me këtë rezultat, Arsenal renditet në vendin e katërt me 11 pikë, 2 më pak se



Siti që komandon Premier Ligë. Ndeshja e radhës për londinezët është ndaj Leicester, sakaq "qytetarët" do kërkojnë maksimumin ndaj Newcastle.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin
Rregullator për Shërbimet e Ujit

Sipas Ligjit nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Komisioni Shqyrtues përbëhet nga kryesuesi i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, një anëtar i emëruar nga Autoriteti dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve, i cili ka parashtruar kërkesën për shqyrtim. Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues zgjedhet për mandat tre (3) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

Kandidati për kryesues të Komisionit Shqyrtues duhet të plotësojë kushtet si në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të ketë së paku diplomë universiteti katër (4) vjeçar ose master;
- të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, mbi gjashtë (6) muaj burgim;
- të ketë integritet të lartë moral;
- të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 7 tetor 2024, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës
www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonësë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo ponovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor predsedavajućeg Komisije za razmatranje pri Regulatornom
autoritetu za usluge voda

Prema Zakonu br. 05/L -042 o regulisanju usluga voda, Komisija za razmatranje se sastoji od predsedavajućeg, izabranog od strane Skupštine Republike Kosova, jednog člana imenovanog od strane Autoriteta i jednog člana imenovanog od strane pružioca usluga koji je podneo zahtev za razmatranje. Predsedavajući Komisije za razmatranje bira se za mandat od tri (3) godine, uz mogućnost ponovnog izbora za samo još jedan mandat.

Kandidat za predsedavajućeg Komisije za razmatranje treba da ispunjava sledeće uslove:

- da je državljanin Republike Kosova;
- da ima najmanje četvorogodišnju (4) univerzitetsku diplomu ili master;
- da nije bio osuđivan za krivična dela, preko šest (6) meseci zatvora;
- da ima visoki moralni integritet;
- da ima najmanje tri (3) godine radnog iskustva u profesiji.

Aplikaciji treba priložiti sledeća dokumenta:

- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi;
- Motivaciono pismo;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografija);
- Dokaz o državljanstvu Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije osuđen za krivično djelo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 7. oktobra 2024. godine u 16.00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Šampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majka Tereza“ bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova -
www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina
Gjimnazi “Sami Frashëri”



Gjimnazi “Sami Frashëri” Nr. 720/03-27 ; Data: 23.09.2024

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 03/2016 për Këshillin Drejtues të shkollës dhe vendimin e KD të dt.19.09.2024, bazuar në nenin 56 Sigurimi Fizik i nxënësve të Rregullores për organizimin e punës në Shkolla të Mesme të Larta të dt.15.02.2016, Gjimnazi “Sami Frashëri” shpallë këtë:

FTESË PËR OFERTË Sigurimi Fizik

I. Informata të përgjithshme
Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë kalendrike nga data e publikimit të ftesës më dt. 23.09.2024 deri më dt. 29.09.2024;

Detyrat dhe përgjegjësit:

- >Monitorin hyrje-daljet e nxënësve duke kontrolluar edhe bartjen e uniformës;
- >Monitoron hapësirat e shkollës në mënyrë të vazhdueshme, rastet e dyshimita, hyrjen e personave të paautorizuar apo cenimin –dëmtimin e pronës së shkollës;
- >Parandalon dhe menaxhon rastet emergjente dhe të dhunës brenda hapësirave të shkollës;
- >Bashkëpunon me drejtorin e shkollës dhe stafin pedagogjik për të garantuar një mjedis të sigurt dhe të qetë për të gjithë;
- >Ndërvepron me drejtorin e shkollës dhe stafin e saj duke ndërhyrë dhe parandaluar rastet e thyerjes së disiplinës , menaxhimit të krizave dhe rasteve emergjente;
- >Evidenton dhe raporton tek drejtoria e shkollës për situatat e parregullta të rendit dhe sigurise brenda hapësirave të shkollës;
- >Harton raporte javore dhe evidenton incidentet e ndryshme;
- >Të jetë komunikativ dhe i aftë të punoj në grupe dhe nën presion;
- >Të jetë i moshës, madhore dhe të mos jetë nën hetime apo i dënuar për veprë penale.
- > Një puntorë për 6 orë pune (E hënë e Premte nga (07,30 deri 13,30) dhe sipas kërkesës.

III. Dokumentet e kërkuara

1. Certifikatën dhe informatat e biznesit së OE dhe licencimi i OE për Sigurim Fizik;
2. Vërtetimi tatimor nga ATK;
3. Qmimi sipas orarit të punës.
4. Deklarata qe operatori dhe puntori nuk janë nën hetime.

IV. Dorëzimi i dokumenteve

1. Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) ditë kalendrike nga data e publikimit të ftesës për ofertë më 23.09.2024 deri më datën 29.09.2024;
2. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në *zarf të mbyllur* në objektin e shkollës;
3. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara bëhet nga Komisioni përkatës në Drejtorinë e shkollës (KDSH, KP,KN) duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
5. Ofertuesi i përzgjedhur merr të gjitha obligimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gazmen Kadriaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Luan Berisha shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Nadire Mehmeti nga Skenderaji shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Alban Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m.e. “Kadri Kusari”.

- Zana Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4. dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër “Bill Clintonit”, kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra “Qerimi2”, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

